

Njoftim

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja Nr.28 Regj. Themeltar, Datë 05.06.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga Altin Kaziaj.

Të paditur: Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pranë Komisionit Qendror Zgjedhor.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve pranë Komisionit Qendror.

Objekti: Shfuqizimin e pikës 2 të Vendimit nr.136, datë 24.05.2023, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) duke vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim pranë KAS.

Më datë **05.06.2023** u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe, sipas tij, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

- 1. Blerona Hasa (Relatore);**
- 2. Marsela Dervishi (Anëtare);**
- 3. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 4. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 5. Alma Kolgjoka (Anëtare).**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, gjatë shqyrtimit më datë 06.06.2023, ora 09:00, të çështjes nr. 26 Regj. Themeltar, Datë 02.06.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Lefter Maliqi, kandidat për kryetar bashkie në Bashkinë Kuçovë, përfaqësuar nga Avokatët Arben Llangozi dhe Orgesa Serani.

Të paditur: Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pranë Komisionit Qendror Zgjedhor.
Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve pranë Komisionit Qendror.

Objekti: Shfuqizimin e pikës 2 të Vendimit nr.136, datë 24.05.2023, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) duke vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim pranë KAS;

vendosi bashkimin e çështjes nr.28 Regj. Themeltar, Datë 05.06.2023 Regjistrimi, me çështjen nr.26 Regj. Themeltar, Datë 02.06.2023 Regjistrimi.

Tiranë, më 06.06.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë